



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.12.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-3633/12, për zyrtaren e Lartë **znj. Burbuqe Berisha, Drejtore e Përgjithshme e Teatrit Kombëtar të Kosovës**, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit Publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli, AKK– 03-3633/12, që për trajtim ka pasur Zyrtaren e Lartë znj. Burbuqe Berisha, Drejtore e Përgjithshme e Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Pas informatës së marr, dhe sipas procedurave ligjore është trajtuar lënda, me dyshimin, së Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve, ka ndarë mjete për financimin e shfaqjes “Darka e Private” e realizuar nga Teatri “Istref Begolli” i Pejës me regji të regjisores znj. Burbuqe Berisha.

Gjatë zhvillimit të procedurës, kemi kërkuar nga Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve, që të na njoftoj se a ka qenë financuese e shfaqjes së realizuar nga Teatri “Istref Begolli” i Pejës me regji të regjisores znj. Burbuqe Berisha.

Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve e ka njoftuar Agjencinë kundër Korrupsionit së Departamenti i Kulturës, nuk e ka mbështetur financiarisht projektin me emër “Darka e Private”.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka kontaktuar edhe znj. Burbuqe Berisha, ku është marre edhe deklarata saj, ku ndër të tjera gjate takimit me të, na ka njoftuar, se pas kërkesës që i është bërë nga Teatri i Pejës, për tu angazhuar si Regjisore në një shfaqje teatrale, ka ndjekur procedurat

ligjore, ku e ka njoftuar Këshillin Drejtues të Teatrit Kombëtar si dhe Ministrin e Kulturës, së do të angazhohet si regjisorë në një shfaqje në Teatrin e Pejës dhe puna atje nuk do të ketë interferim me punën zyrtare si Drejtore në Teatrin Kombëtar të Kosovës, si dhe ka kërkuar nga Teatri i Pejës “Istref Begolli” që shfaqja të mos jete e financuar nga Ministria e Kulturës dhe mos të ketë asnjë obligim nga MKRS, pasi që mund të ketë Konflikt të Interesit.

Bazuar në faktet dhe në argumentet e mbledhura është konstatuar se zyrtarja e lartë znj. Burbuqe Berisha, Drejtore e Përgjithshme e Teatrit Kombëtar të Kosovës, nuk është gjendur në Konflikt të Interesit, pasi që angazhimi i saj profesional si regjisorë në shfaqjen “Darka Private” e realizuar në Teatrin “Istref Begolli” të Pejës nuk është financuar nga Ministria e Kulturës Rinis dhe Sporteve dhe angazhimi i saj në veprimtarin private në fushën e kulturës si Regjisorë nuk paraqet konflikt të Interesit.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

